

**Devoll Hydropower Sh.A.**  
**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe**  
**Pasqyrat Financiare**  
**më dhe për vitin e mbyllur**  
**më 31 dhjetor 2010**

## Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	3
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	6
Pasqyra e flukseve monetare	7
Shënime mbi pasqyrat financiare	8 - 28

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për drejtuesit dhe aksionarët e Devoll Hydropower Sh.A.

#### *Raporti mbi Pasqyrat Financiare*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Devoll Hydropower Sh.A. bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2010 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

#### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo pasaktësive.

#### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

#### *Opinionit*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Devoll Hydropower Sh.A. më 31 dhjetor 2010 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

*Deloitte Albania shpk*

Tiranë  
15 mars 2011

**Devoll Hydropower Sh.A.****Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2010**

Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

	Shënime	Më 31 dhjetor 2010	Më 31 dhjetor 2009
<b>Aktivet</b>			
Prona, makineri dhe pajisje	7	2,048,012,910	583,977,811
Aktive jomateriale	8	9,820,756	5,830,182
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>2,057,833,666</b>	<b>589,807,993</b>
Parapagime	9	10,312,633	8,377,066
Parapagim i tatim fitimit		105,033	105,033
Të tjera aktive afatshkurtra	10	286,913,231	31,134,152
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	11	340,497,212	742,845,940
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>637,828,109</b>	<b>782,462,191</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>2,695,661,775</b>	<b>1,372,270,184</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	12	2,865,990,000	1,083,950,000
Humbja e akumuluar		(411,700,063)	(216,979,635)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>2,454,289,937</b>	<b>866,970,365</b>
<b>Detyrimet</b>			
Shpenzime të përlogaritura	13	213,465,624	472,747,922
Llogari te pagueshme	14	22,770,051	31,306,925
Detyrime të tjera	15	5,136,163	1,244,972
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>241,371,838</b>	<b>505,299,819</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>241,371,838</b>	<b>505,299,819</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>2,695,661,775</b>	<b>1,372,270,184</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 8 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Në emër të Devoll Hydropower Sh.A.


*Helwig Überacker*  
Helwig Überacker  
Drejtori Ekzekutiv

*Ola By*  
Ola By  
Drejtori Teknik

*Frank Almaas*  
Frank Almaas  
Drejtori Operacional

*Mario Niederwolfsgruber*  
Mario Niederwolfsgruber  
Drejtori Financës

*KPMG*  
Përgatitur nga:  
KPMG Albania Sh.p.k.

**KPMG Albania Sh.p.k.**

**Devoll Hydropower Sh.A.****Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010**

Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009
Të ardhura		-	-
Shërbime	16	(178,795,763)	(222,481,367)
Shpenzime personeli	17	(16,181,653)	(6,205,201)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	7	(6,916,158)	(921,672)
Amortizimi i aktiveve jomateriale	8	(1,898,576)	(60,959)
Shpenzime të tjera	18	(24,545,757)	(2,952,243)
<b>Humbja nga aktivitetet operative</b>		<b>(228,337,907)</b>	<b>(232,621,442)</b>
<b>Të ardhurat financiare neto</b>			
Fitimet nga kurset e këmbimit, neto	19	16,195,596	15,094,265
Të ardhura financiare, neto	20	17,421,883	502,839
		<b>33,617,479</b>	<b>15,597,104</b>
<b>Humbja para tatimit mbi fitimin</b>		<b>(194,720,428)</b>	<b>(217,024,338)</b>
Shpenzime të tatimi mbi fitimin	21	-	-
<b>Humbja e vitit</b>		<b>(194,720,428)</b>	<b>(217,024,338)</b>
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(194,720,428)</b>	<b>(217,024,338)</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 8 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Devoll Hydropower Sh.A.**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010**  
 Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

	Kapitali aksionar	Humbja e akumuluar	Totali
<b>Gjëndja më 1 janar 2009</b>	<b>2,000,000</b>	<b>44,703</b>	<b>2,044,703</b>
<i>Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin</i>			
Humbja e vitit	-	(217,024,338)	(217,024,338)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>(217,024,338)</b>	<b>(217,024,338)</b>
<i>Transaksione me pronarët të regjistruara direkt në kapital</i>			
Kontribute nga pronarët	1,081,950,000	-	1,081,950,000
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2009</b>	<b>1,083,950,000</b>	<b>(216,979,635)</b>	<b>866,970,365</b>
<i>Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin</i>			
Humbja e vitit	-	(194,720,428)	(194,720,428)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>(194,720,428)</b>	<b>(194,720,428)</b>
<i>Transaksione me pronarët të regjistruara direkt në kapital</i>			
Kontribute nga pronarët	1,782,040,000	-	1,782,040,000
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2010</b>	<b>2,865,990,000</b>	<b>(411,700,063)</b>	<b>2,454,289,937</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 8 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Devoll Hydropower Sh.A.**

**Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010**

Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009
<b>Aktivitetet operative</b>		
Humbja e vitit	(194,720,428)	(217,024,338)
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin	7 6,916,158	921,672
Zhvlerësimin	8 1,898,576	60,959
Të ardhura nga interesat	20 (17,421,883)	(502,839)
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>		
Rritja në parapagime	9 (1,935,567)	(8,377,066)
Rritja në aktivet e tjera	10 (255,779,079)	(31,134,152)
(Rënia)/rritja në llogaritë e pagueshme	14 (8,536,874)	31,306,925
(Rënia)/rritja në shpenzimet e përlllogaritura dhe të tjera detyrime	13,15 (255,391,107)	473,992,894
<i>Flukset monetare gjeneruar nga aktivitetet operative</i>	<i>(724,970,204)</i>	<i>249,244,055</i>
Interesa të arkëtuara	17,421,883	502,839
Tatim fitimi i paguar	-	(110,000)
<b>Flukset monetare gjeneruar nga aktivitetet operative</b>	<b>(707,548,321)</b>	<b>249,636,894</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerja e pronave, makinerive dhe pajisjeve dhe aktiveve jomateriale	7,8 (1,476,840,407)	(590,790,624)
<b>Flukset monetare përdorur nga aktivitetet investuese</b>	<b>(1,476,840,407)</b>	<b>(590,790,624)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
Kontribute nga pronarët	12 1,782,040,000	1,081,950,000
<b>Flukset monetare përdorur nga aktivitetet financuese</b>	<b>1,782,040,000</b>	<b>1,081,950,000</b>
Ndryshimi neto i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to	(402,348,728)	740,796,270
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentet me to më 1 Janar 2010</b>	<b>742,845,940</b>	<b>2,049,670</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentet me to më 31 dhjetor 2010</b>	<b>11 340,497,212</b>	<b>742,845,940</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 8 - 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

**1. Të përgjithshme**

**Informacion i përgjithshëm për Shoqërinë**

Devoll Hydropower Sh.A. ("Shoqëria") është themeluar dhe e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar. Devoll Hydropower Sh.A. është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), me NIPT K82418002C në datën 18 Dhjetor 2008 dhe aktualisht administrohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Tiranës.

Bazuar në Ligjin Nr. 10083 të datës 23.02.2009, shoqëritë EVN AG, Statkraft AS dhe Devoll Hydropower Sh.A. u lajmëruan se ishin fitues të Marrëveshjes së Koncesionit BOOT me objekt ndërtimin dhe shfrytëzimin e Hidrocentraleve të Devollit, me vendndodhje në pjesën e mesme dhe të sipërme të luginës së lumit Devoll, midis komunës Maliq dhe Banjë.

EVN AG dhe Statkraft AS krijuan në Shqipëri një shoqëri aksionare që vepron nën emrin Devoll Hydropower Sh.A, e cila u përfshi në Marrëveshjen e Koncesionit si shoqëri koncesionare.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është:

Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Zyra Nr.1204, Tiranë.

**Marrëveshja e Koncesionit – terma të rëndësishëm**

Sipas nenit 78 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe Ligjit Shqiptar Nr. 9663 "Për koncesionet" i datës 18 dhjetor 2006, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 463 "Mbi aprovimin e autoritetit kontraktues për financimin e kocensionit për hidrocentralet në kaskadën e lumit Devoll dhe aprovimin e bonusit në procedurën për përzgjedhjen e ofertës së Shoqërisë" i datës 18.07.2007, Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10083 "Mbi aprovimin e Marrëveshjes Koncesionare ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE) dhe EVN AG, STATKRAFT AS dhe DEVOLL HYDROPOWER SHA, si bashkë koncesionare për planifikimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit hidroenergjitik mbi lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë" data 23.02.2009 (Marrëveshja e Koncesionit). Sipas Marrëveshjes së Koncesionit, Shoqëria do të ndërtojë të paktën tre hidrocentrale me një kapacitet total rreth 319 MW (+/- 20%) dhe me një prodhim mesatar përafërsisht 985 GWh.

Koncesioni për hidrocentralet përfshin planifikimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e tre projekteve hidroelektrike të vendosura në pjesën e mesme dhe të sipërme të luginës së lumit Devoll. Në përputhje me koncesionin për hidrocentralin, trualli i ndërtimit, përdorimi i ujit të luginës së lumit Devoll ndërmjet lartësive 95-810 metra mbi nivelin e detit, përfshirë dhe Lumin Devoll dhe degëzimet e tij do të transferohen Devoll Hydropower Sh.A.

Sipas marrëveshjes së koncesionit, koncesionari është i lejuar që të furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda ose jashtë Shqipërisë (që do të prodhohet nga koncesionari). Kjo Marrëveshje Koncesionit përbën është organizuar si një model projekti BOOT (Ndërtim-Zotërim-Operim-Transferim) dhe do të zgjasë për një periudhë prej 35 vjetësh me të drejtë zgjatjeje automatike pas përmbushjes së disa kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Koncesionit. Pas kësaj periudhe hidrocentrali do të transferohet METE-s pa asnjë tarifë bashkë me pajisjet e lidhura operuese, të drejtat e dhëna dhe kontratat.



Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

**2. Bazat e përgatitjes**

**(a) Deklarata e përpuethshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin Shqiptar Nr. 9228, datë. 29.04.2004 "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë autorizuar për publikim nga Bordi i Drejtorëve më 15 mars 2011.

**(b) Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

**(c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

**(d) Përdorimi i parashikimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon nevojën e menaxhimit për të bërë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë përfshirë në shënimin 5.

**3. Politika të rëndësishme kontabël**

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

**(a) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale sipas kurseve të këmbimit në datat e transaksioneve. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e asaj date. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës së raportimit.

Zërat jo monetare që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

**(b) Instrumentat financiare**

Fillimisht Shoqëria i njeh llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në mjete monetare në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivitet e tjera financiare (përfshirë aktivitet e njohura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimeve apo humbjeve) janë njohur fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuale të instrumentit.

Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

**3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(b) Instrumentat financiare (vazhdim)**

Shoqëria nuk e njih një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktivi skadojnë ose kur ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset e parasë kontraktuale të aktivitetit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë risqet dhe përfitimet nga zotërimi i aktivitetit financiar transferohen. Cdo interes në aktivet financiare të transferuara që është krijuar apo përfutur prej Shoqërisë njihet si një aktiv apo detyrim i vecantë.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera neto e tyre e paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të netuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përftojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë. Instrumentat financiare jo derivative të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalente të saj, detyrimet tregtare dhe të tjera.

*Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat me afat maturimi me më pak se tre muaj.

*Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme janë fillimisht të njohura me vlerë të drejtë dhe më pas të matura me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

*Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e detyrimeve tregtare dhe të tjera janë deklaruar me vlerë të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Të tjera*

Të tjera instrumenta financiare jo derivative janë të matura me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

*Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

**(c) Aktive afatgjata materiale**

*(i) Njohja dhe matja*

Zëri prona, makineri dhe pajisje është matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe cdo kosto tjetër direkte të lidhur me të për vënie e aktivitetit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e emontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Blerja e një programi që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje të lidhur me të është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një prone, makinerie dhe pajisjeje kanë jetë-gjatësi të ndryshme, ato llogariten si të ndara (pjesë të rëndësishme) të pronave, makinerive dhe pajisjeve.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të prone, makineri dhe pajisjeje janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pronës, makinerisë dhe pajisjes dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e të ardhurave ose shpenzimeve.

Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

**3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(c) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

*(ii) Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën e mbartur të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do ti vijnë Shoqërisë dhe kostoja e saj mund të matet me besueshmëri. Vlera e mbartur e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat dhe shpenzimet sipas rastit të ndodhur.

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur.

Amortizimi njihet në të ardhurat dhe shpenzimet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për pajisjet e zyrës me një normë vjetore amortizimi prej 20%, për pajisjet informatike një normë vjetore amortizimi prej 25% dhe për mjetet e transportit një normë vjetore amortizimi prej 20%. Kjo është mënyra e cila reflekton më mirë konsumin e përfitimeve të ardhshme ekonomike të materializuara në aktiv.

Punimet në zyrë amortizohen përgjatë afatit të qerave. Aktivet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura të pronave, makinerive dhe pajisjeve, nëse ka qenë e pa rëndësishme janë rishikuar në datën e raportimit.

**(d) Aktive afatgjata jomateriale**

*(i) Njohja dhe matja*

Aktivitet jo-materiale të cilat janë blerë nga Shoqëria, maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

*(ii) Kostot vijuese*

Kostot vijuese kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të materializuara në një aktiv specifik me të cilat ato lidhen. Të gjithë shpenzimet e tjera duke përfshirë shpenzimet e krijuari së brendshmi për emrin e mirë dhe markën, njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur ndodhin.

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi koston e aktivit duke i zbritur vlerën e mbetur.

Amortizimi është njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për programet kompjuterike me një normë amortizimi vjetore prej 25%.

**(e) Zhvlerësimi**

*(i) Aktivet financiare*

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është vlerësuar në cdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive për ta zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi që tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare të atij aktivit financiar dhe mund të maten në mënyrë të besueshme.

Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

**3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(e) Zhvlerësimi (vazhdim)**

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit të aktivit. Humbjet janë njohur në të ardhura ose shpenzime dhe janë reflektuar në një llogari zbritje nga llogaritë e arkëtueshme. Interesi mbi një aktiv të zhvlerësuar vazhdon të njihet nëpërmjet uljes së skontimit. Kur një ngjarje e ardhshme (shlyerja e një debitori) shkakton një rënie në shumën e zhvlerësimit, rënia në humbjen nga zhvlerësimi rrimet si e ardhur ose shpenzim.

*(ii) Aktivet jo-financiare*

Vlerat e mbartura të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë duke zbritur kostot e shitjeve dhe vlerën në përdorim. Për përcaktimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare janë skontuar për gjetjen e vlerës së tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të aktivit për të cilat nuk janë bërë ndryshime në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare.

Humbja nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo njësisia e saj e krijimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje.

**(f) Përfitimet e punëmarrësve**

*Kontributet e detyrueshme shoqërore*

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim i përfitimit të punonjësve në fitim ose humbje në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

**(g) Provigjionet**

Një provigjion njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime aktuale ligjore ose konstruktive, të cilat mund të parashikohen me besueshmëri, dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provigjionet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të flukseve të parasë të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet e tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimeve. Amortizimi i skontimit është njohur si kosto financiare.

**(h) Njohja e të ardhurave**

E ardhura është përfitimi ekonomik bruto që lind gjatë një periudhe nga kryerja e aktiviteteve të zakonshme të Shoqërisë.

*(i) Mallrat e shitura*

E ardhura nga shitja e mallrave gjatë rrjedhës së aktiviteteve të zakonshme matet me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, neto nga kthimet, zbritjet tregtare dhe rabatet për sasi, nëse ka. E ardhura njihet kur ka evidenca bindëse se risqet e rëndësishme dhe të drejtat e pronësisë i janë transferuar blerësit, mbulimi i pagesës është i mundshëm, kostot e shoqëruara dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të parashikohen me besueshmëri, nuk ka ndërhyrje të vazhdueshme të menaxhimit tek mallrat, dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Nëse ekziston mundësia që të bëhen zbritje dhe shuma mund të matet me besueshmëri, atëherë zbritja njihet si një zvogëlim i të ardhurave sic janë njohur shitjet.

Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

**3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(h) Njohja e të ardhurave (vazhdim)**

*(ii) Shërbimet*

E ardhura nga kryerja e shërbimeve është njohur në fitim ose humbje në përpjesëtim me fazën e përmbushjes të transaksionit në datën e raportimit. Faza e përmbushjes vlerësohet duke iu referuar vrojtimit të punës së kryer.

**(i) Pagesat e qirasë**

Qiratë janë klasifikuar si qira financiare sa herë që sipas kushteve të qerasë transferohen të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë tek qiramarrësi. Te gjitha qiratë e tjera janë klasifikuar si qira operative. Pagesat e bëra për qiratë operative janë njohur në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë. Lehtësirat e përfituara të qirasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

Pagesat minimale të bëra për qiratë financiare janë ndarë midis shpenzimeve financiare dhe reduktimit të detyrimeve të papaguara. Shpenzimi financiar është shpërndarë në çdo periudhë gjatë afatit të qirasë në mënyrë që të prodhojë një normë konstante periodike të interesit për gjëndjen e mbetur të detyrimit.

**(j) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen neto.

**(k) Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin peçëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për tu paguar mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në cdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

**(l) Standardet dhe interpretimet e reja ende të pa aplikueshme**

Një numër standardesh të reja, ndryshime të standardeve dhe interpretimeve të standardeve janë efektive për vitet që fillojnë pas datës 1 janar 2010 (të listuara më poshtë), dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto nuk priten të ketë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë, me përjashtim të SNRF 9 *Instrumentat financiare*, e cila është e detyrueshme për pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin 2013 dhe mund të ndryshojë klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Shoqëria nuk planifikon të adoptojë më herët këtë standard dhe shtrirja e ndikimit nuk është përcaktuar.

Shumat në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe

**3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(l) Standartet dhe interpretimet e reja ende të pa aplikueshme**

- SNRF 9 *Instrumentat Financiare* (efektive për periudhat financiare që fillojnë më 1 Janar 2013) publikuar në Nëntor 2009 dhe e ndryshuar në Tetor 2010 prezanton kërkesat e reja për klasifikimin dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare si dhe për mosnjohjen e tyre. SNRF 9 kërkon që të gjitha aktivet financiare të njohura dhe që përfshihen në objektin e SNK 39 Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja në vijësi të bëhen me koston e amortizuar të vlerës së drejtë. Në mënyrë të vecantë, investimet në borxhe të mbajtura në një model biznesi qëllimi i të cilit është të mbledhë flukset monetare të kontraktuara të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe e interesit si dhe e interesit mbi principalin e mbetur, në përgjithësi janë matur me koston e amortizuar në fund të periudhës së ardhshme kontabël. Efekti më i rëndësishëm i SNRF 9 në lidhje me klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare ka të bëjë me kontabilitetin për ndryshimet në vlerën e drejtë të një detyrimi financiar (përcaktuar në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) që u atribuohen ndryshimeve në riskun e kredisë të këtij detyrimi. Manaxhimi parashikon që SNRF 9 do të adoptohet në pasqyrat financiare të Shoqërisë për periudhën vjetore që fillon më 1 Janar 2013. Megjithatë nuk është praktike që të sigurohet një vlerësim i arsyeshëm i efektit në vlerat e raportuara përkatësisht në aktivet dhe detyrimet financiare derisa të jetë bërë një shqyrtim i hollësishëm,
- Ndryshimet në SNRF 1 *"Zbatimi për Herë të parë i SNRF"* – Përfshirja e Kufizuar nga Informacioni Krahasues i SNRF 7 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për zbatuesit e herës së parë* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2010),
- Ndryshimet e SNRF 7 emërtuar *Paraqitja – Transferimi i Aktiveve Financiare* rrit kërkesat për paraqitjen e informacioneve shpjeguese që përfshijnë transferimet e aktiveve financiare (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2011),
- Ndryshimet e SNK 24 *"Paraqitja e Palëve të Lidhura"* – Thjeshtimi i kërkesave për dhënie të informacioneve shpjeguese për subjektet shtetërore të lidhura dhe qartësimi i përcaktimit të palës së lidhur (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2011),
- Ndryshimet e SNK 32 *"Instrumentat Financiare: Prezantimi"* – Kontabiliteti për emetimin e të drejtave (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Shkurt 2010),
- KIRFN 19 *"Heqja e Detyrimeve Financiare me Instrumentat e Kapitalit"* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2010),
- Ndryshimeve të standarteve dhe interpretimeve të ndryshme *"Përmirësimet e SNRF-ve (2010)"* që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve e publikuar më 6 Maj 2010 (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 7, SNK 1, SNK 27, SNK 34, KIRFN 13) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit (shumë prej ndryshimeve do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2011),
- Ndryshimet e KIRFN 14 *"SNK 19 Kufizimi në një Aktiv me përfitim të përcaktuar, Kërkesat Minimale për Financim dhe Ndërveprimi i tyre"* – Parapagimet e Kërkesës Minimale Për Financim (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2011).

**(m) Standardet dhe Interpretimet të aplikueshme në periudhën aktuale.**

Ndryshimet që vijojnë të standarteve ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar Ndërkombëtar janë efektive për periudhën aktuale:

- SNRF 1 (i rishikuar) *"Adaptimi për Herë të parë i SNRF-ve"* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2009)

**2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**(m) Standardet dhe Interpretimet efektive në periudhën aktuale.**

- SNRF 3 (i rishikuar) *“Kombinimi i bizneseve”* (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2009),
- Ndryshimet e SNK 27 *“Pasqyrat Financiare Individuale dhe të Konsoliduara”* (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2009),
- Ndryshimet e SNRF 1 *Adaptimi për Herë të parë i Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar – Përfshirjet Shtesë për Adaptuesit e Herës së parë.* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2010),
- Ndryshimet e SNRF 1 *Adaptimi për Herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar – Zëvendësimi i ‘datave të përcaktuara’ për disa përjashtime me ‘datën e kalimit në SNRF’* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2011),
- Ndryshime të SNRF 1 *Adaptimi për Herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar – Përfshirjet shtesë për entitetet që nuk vuajnë më nga hiperinflacioni i rëndë* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2011),
